



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

PËRBALLË MUNDËSIVE DHE DYSHIMEVE: PERSPEKTIVAT E DREJTUESVE DHE MËSIMDHËNËSVE MBI PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Autori:

Rita Llumica

Mentori:

Iliriana Tahiraj, Prof. Asst. Dr

Programi:

Master në Shkenca të Edukimit: Udhëheqja në Arsim

Viti akademik:

28/05/2026

Zhvillimi i teknologjisë ka sjellë integrimin e inteligjencës artificiale (IA) në arsim, duke mundësuar përmirësimin e proceseve mësimore dhe administrative. Në Kosovë, përdorimi i IA-së, veçanërisht ChatGPT, është në rritje, por vazhdon të mbetet kryesisht joformal dhe i paregulluar nga politika të qarta institucionale. Pavarësisht potencialit të madh që ofron IA për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë në arsim, përdorimi i saj ngre edhe çështje të rëndësishme që lidhen me etikën, privatësinë, sigurinë e të dhënave dhe ndryshimin e rolit tradicional të mësimeve. Në dokumentet e fundit evropiane, si Korniza Digjitale Evropiane DigComp 2.2 dhe Akti Evropian për Inteligjencën Artificiale, theksohet rëndësia e zhvillimit të kompetencave digjitale dhe përdorimit të përgjegjshëm të IA-së. Këto zhvillime tregojnë nevojën që edhe sistemi arsimor i Kosovës të ndërtojë politika, udhëzime dhe programe trajnimi që mbështesin integrimin etik dhe efektiv të inteligjencës artificiale në shkolla.

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë perspektivat dhe përvojat e drejtuesve të shkollës (zëvendësrektorit dhe pedagogut) dhe të mësimeve lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale në arsimin parauniversitar. Studimi synon të identifikojë mënyrat e përdorimit të IA-së, përfitimet dhe sfidat që perceptohen nga pjesëmarrësit, si dhe nevojat për trajnim, mbështetje institucionale dhe politika që mundësojnë një integrim të qëndrueshëm dhe etik të saj në procesin edukativo-arsimor. Pyetjet kryesore të hulumtimit janë: (1) Cilat janë perspektivat e

drejtuesve dhe mësimehdhënësve mbi përdorimin e inteligjencës artificiale në arsimin parauniversitar? (2) Cilat janë përfitimet dhe sfidat kryesore që ata identifikojnë në përdorimin e IA-së në shkollë? dhe (3) Çfarë nevojash për trajnim dhe mbështetje shohin mësimehdhënësit dhe drejtuesit për përdorimin efektiv dhe etik të inteligjencës artificiale në shkollë?

Studimi është realizuar duke përdorur metodën cilësore dhe dizajnin e studimit të rastit (Case Study), me qëllim shqyrtimin e perspektivave të drejtuesve dhe mësimehdhënësve për përdorimin e inteligjencës artificiale në arsimin parauniversitar (Creswell and Poth, 2018). Mostra ka qenë e qëllimshme, ku janë përfshirë nëntë pjesëmarrës (zëvendësdrejtori i shkollës, pedagogu dhe shtatë mësimehdhënës) nga një shkollë në Komunën e Prishtinës. Të dhënat u mbledhën përmes intervistave gjysmë të strukturuar dhe u analizuan me metodën e analizës tematike sipas modelit të Braun dhe Clarke (2006), duke identifikuar temat kryesore që lidhen me përfitimet, sfidat dhe nevojat për mbështetje në përdorimin e IA-së.

Rezultatet e studimit tregojnë se niveli i njohurive të drejtuesve dhe mësimehdhënësve për inteligjencën artificiale (IA) është kryesisht bazik deri në mesatar, ndërsa shumica e njohurive janë fituar në mënyrë individuale përmes internetit, përdorimit praktik dhe interesimit personal, për shkak të mungesës së trajnimeve zyrtare dhe udhëzimeve institucionale. Përdorimi i IA-së në shkollë është në rritje dhe përqendrohet kryesisht në përgatitjen e materialeve mësimore, planeve mësimore, testeve, ushtrimeve dhe aktiviteteve për nxënësit. Pjesëmarrësit e perceptojnë IA-në si një mjet që kursen kohë, lehtëson punën administrative dhe mbështet personalizimin e procesit të të nxënësve. Nga ana tjetër, janë identifikuar edhe disa shqetësime, si varësia e tepruar nga teknologjia, ulja e mendimit kritik të nxënësve, kopjimi i detyrave pa kuptim të përmbajtjes, si dhe rreziqet që lidhen me saktësinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkaq të gjithë, pjesëmarrësit theksuan nevojën për trajnime profesionale, udhëzime administrative dhe mbështetje institucionale për integrimin e sigurt dhe efektiv të inteligjencës artificiale në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, u konstatua mungesa e objektivave dhe dokumenteve specifike që adresojnë përdorimin e IA-së në planifikimin zhvillimor të shkollës.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) në shkollë mbetet kryesisht individual dhe pa një strategji të qartë institucionale, gjë që ndikon në mungesën e një qasjeje të unifikuar dhe në dallimet e qëndrimeve mes mësimehdhënësve. Këto gjetje janë në përputhje me Fullan (2023), i cili thekson se inovacionet arsimore kërkojnë leadership të fortë dhe vizion të përbashkët institucional për të qenë të qëndrueshme. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit

shprehin qëndrim përgjithësisht pozitiv ndaj dobishmërisë së IA-së, duke e parë atë si mjet që rrit efikasitetin në përgatitjen e materialeve dhe përmirëson procesin mësimor. Kjo përputhet me Modelin TAM dhe gjetjet e Çetin et al. (2024), si dhe Harry & Sayudin (2023), të cilët theksojnë se IA rrit produktivitetin dhe cilësinë e mësimdhënies. Megjithatë, studimi identifikon edhe pasiguri dhe hezitim të lidhur me çështje etike, saktësinë e informacionit dhe ndikimin në mendimin kritik, në përputhje me Southgate et al. (2019). Po ashtu, mungesa e trajnimeve dhe mbështetjes institucionale ndikon negativisht në lehtësinë dhe pranimin e përdorimit të IA-së (Hwang et al., 2025).

Studimi konkludon se IA përdoret kryesisht në mënyrë individuale, ndërsa potenciali i saj për përmirësim të mësimdhënies është i lartë, por i kufizuar nga mungesa e trajnimeve, udhëzimeve dhe strategjive institucionale. Gjithashtu, ekzistojnë shqetësime etike dhe pedagogjike që kërkojnë trajtim më të kujdesshëm.

Rekomandohet forcimi i lidershit shkollor, hartimi i strategjive institucionale për IA, organizimi i trajnimeve profesionale, përmirësimi i infrastrukturës teknologjike dhe zhvillimi i udhëzimeve të qarta për përdorim etik. Po ashtu, sugjerohet realizimi i studimeve të mëtejshme me përfshirje më të gjerë të pjesëmarrësve, përfshirë edhe nxënësit dhe prindërit. Bazuar në gjetjet e studimit, këto rekomandime dalin nga fakti se përdorimi i IA-së në shkolla është ende individual dhe pa planifikim institucional. Prandaj, forcimi i lidershit dhe hartimi i strategjive institucionale janë të nevojshme për të siguruar një përdorim të koordinuar dhe të qëndrueshëm të IA-së në arsim. Duke qenë se pjesëmarrësit kanë shprehur mungesë njohurish dhe pasiguri, rekomandohen trajnime profesionale dhe përmirësim i infrastrukturës teknologjike për të lehtësuar përdorimin e IA-së në praktikë. Gjithashtu, për shkak të shqetësimeve etike, kërkohen udhëzime të qarta për përdorim të përgjegjshëm të saj. Në fund, sugjerohet zgjerimi i studimeve të ardhshme me më shumë pjesëmarrës, përfshirë nxënësit dhe prindërit.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, arsim, perspektiva, përvoja, mësimdhënës, drejtues shkollorë.

Extended Abstract

Title of the Paper:

FACING OPPORTUNITIES AND DOUBTS: LEADERS' AND TEACHERS' PERSPECTIVES ON THE USE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION

Author:

Rita Llumnica

Mentor:

Iliriana Tahiraj, Prof. Asst. Dr

Program:

Master of Science in Education: Leadership in Education

Academic Year:

28/05/2026

The development of technology has led to the integration of artificial intelligence (AI) in education, enabling the improvement of teaching and administrative processes. In Kosovo, the use of AI, particularly ChatGPT, is increasing, but it remains largely informal and unregulated by clear institutional policies. Despite the significant potential of AI to enhance efficiency and quality in education, its use also raises important issues related to ethics, privacy, data security, and the changing role of the teacher. Recent European frameworks, such as the Digital Competence Framework for Citizens (DigComp 2.2) and the European Artificial Intelligence Act, emphasize the importance of developing digital competencies and the responsible use of AI. These developments indicate the need for Kosovo's education system to develop policies, guidelines, and training programs that support the ethical and effective integration of artificial intelligence in schools.

The aim of this study is to examine the perspectives and experiences of school leaders (deputy principals and school pedagogues) and teachers regarding the use of artificial intelligence in pre-university education. The study seeks to identify the ways AI is used, the perceived benefits and challenges, as well as the needs for training, institutional support, and policies that enable a sustainable and ethical integration of AI into the educational process. The main research questions are: (1) What are the perspectives of school leaders and teachers on the use of artificial intelligence in pre-university education? (2) What are the main benefits and challenges they identify in the use of AI in schools? and (3) What training and support needs do teachers and school leaders identify for the effective and ethical use of artificial intelligence in schools?

The study was conducted using a qualitative methodology and a case study design, aiming to explore the perspectives of school leaders and teachers on the use of artificial intelligence in pre-university education (Creswell and Poth, 2018). The sample was purposive and included nine participants (a deputy principal, a school pedagogue, and seven teachers) from one school in the Municipality of Pristina. Data were collected through semi-structured interviews and analyzed using thematic analysis following Braun and Clarke's (2006) model, identifying key themes related to benefits, challenges, and support needs in the use of AI.

The findings of the study show that the level of knowledge among school leaders and teachers regarding artificial intelligence (AI) is mostly basic to moderate, while most of this knowledge has been acquired individually through the internet, practical use, and personal interest, due to the lack of formal training and institutional guidelines. The use of AI in schools is increasing and is mainly focused on the preparation of teaching materials, lesson plans, tests, exercises, and student activities. Participants perceive AI as a tool that saves time, facilitates administrative work, and supports the personalization of the learning process. On the other hand, several concerns were identified, such as over-reliance on technology, a reduction in students' critical thinking, copying of assignments without understanding the content, as well as risks related to information accuracy and data privacy. All participants emphasized the need for professional training, administrative guidelines, and institutional support for the safe and effective integration of artificial intelligence in pre-university education. Furthermore, a lack of specific objectives and documents addressing the use of AI in school development planning was identified.

The results of this study indicate that the use of artificial intelligence in schools remains largely individual and without a clear institutional strategy, which contributes to the lack of a unified approach and differences in attitudes among teachers. These findings are consistent with Fullan (2023), who emphasizes that educational innovations require strong leadership and a shared institutional vision to be sustainable. On the other hand, participants generally express a positive attitude toward the usefulness of AI, viewing it as a tool that increases efficiency in material preparation and improves the teaching process. This aligns with the Technology Acceptance Model (TAM) and the findings of Çetin et al. (2024), as well as Harry & Sayudin (2023), which highlight that AI increases productivity and teaching quality. However, the study also identifies uncertainty and hesitation related to ethical issues, information accuracy, and the impact on critical thinking, in line with Southgate et al. (2019). In addition, the lack of training and

institutional support negatively affects the ease of use and acceptance of AI (Hwang et al., 2025).

The study concludes that AI is mainly used individually, while its potential to improve teaching is high but limited by the lack of training, guidelines, and institutional strategies. Ethical and pedagogical concerns also require careful consideration.

It is recommended to strengthen school leadership, develop institutional AI strategies, organize professional training, improve technological infrastructure, and create clear guidelines for ethical use. Furthermore, it is suggested that further studies be conducted with a broader range of participants, including students and parents. Based on the findings of the study, these recommendations arise from the fact that the use of AI in schools is still individual and lacks institutional planning. Therefore, strengthening leadership and developing institutional strategies are necessary to ensure coordinated and sustainable use of AI in education. Since participants expressed a lack of knowledge and uncertainty, professional training and improved technological infrastructure are recommended to facilitate practical use of AI. Additionally, due to ethical concerns, clear guidelines for responsible use are required. Finally, expanding future research with more participants, including students and parents, is suggested.

Keywords: artificial intelligence, education, perspectives, experiences, teachers, school leaders.